

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e pestë të rregullt, e mbajtur më datën 04.06.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.31/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 29.05.2025

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e katërt e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.04.2025.


Neni 2


Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e katërt e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.04.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević





PROCESVERBALI

Nga mbledhja e katërt e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 29.04.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 14 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë: Dejan Jevtiq, Dragan Maksimoviq, Millosh Dimiq, Dushan Borisavljeviq dhe Granit Gashi. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesi i OSBE-së, drejtorët e drejtorive komunale: të Buxhetit dhe Financave, të Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimeve, të Kadastrës, të Shërbimeve Publike, të Bujqësisë dhe Pylltarisë, pastaj Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar me dy pikë plotësuese.

Kryesuesi tha se pas caktimit të mbledhjes janë pranuar dy kërkesa për plotësimin e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ndërmarrjes publike “Ekologjia”, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit nr.29-2025-KG për shfuqizimin e Vendimit nr.1065/25 të datës 25.03.2025 (nr.17/2025/KG) për ndryshimin e emrit të rrugës nga “Pensilvania” në “Ohio”, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës me dy pikë plotësuese.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës me dy pike plotësuese.

Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Dejan Jevtiq, gjithsej janë të pranishëm 15 asamblistë dhe ka kuorum.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës me dy pikë plotësuese.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës me dy pike plotësuese:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja urgjente, e mbajtur më datën 07.04.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes së mjeteve të pashpenzuara financiare nga viti 2024 në vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
5. Rishqyrtimi dhe miratimi i Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit 2024-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integriteteve, Nebojsa Millovanoviq.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Vlladica Trajkoviq.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Nënmarjes publike “Ekologjia”, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariç.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit nr.29-2025-KG për shfuqizimin e Vendimit nr.1065/25 të datës 25.03.2025 (nr.17/2025/KG) për ndryshimin e emrit të rrugës nga “Pensilvania” në “Ohio”, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Kadastrës për aktivitetet dhe të hyrat për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Dushan Fillipoviq.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përjashtimin e Shoqatës së gjuetarëve “Graçanica” nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për periudhën prej 12 muajsh, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.
13. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.

14. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja urgjente, e mbajtur më datën 07.04.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se në tabelën e paraqitur shihet se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e parë të vitit 2025 është 9,753,667.11€. Është bërë alokimi i mjeteve në një shumë prej 4,154,518.98€, ndërsa janë shpenzuar 1,774,791.86€. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,086,787,64€, mallra dhe shërbime 374,732.77€, shpenzime komunale 55,616.62€, subvencione dhe transfere 42,435.00€ ndërsa për investime kapitale 215,219.83€. Për tre muaj janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 554,709.54 € ose 20.32% e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2025. Krahësuar me tremujorin e parë të vitit 2024, janë shpenzuar 240,773.65 € më pak ose 11.94%, ndërsa të hyrat vetanake ishin 51,443.36 € ose 10.22% më të larta krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, pyeti a ka pasur kërkesa për donacione për organizata që kanë nevojë, si për shembull për veshje tradicionale.

Drejtori Sllavisha Niçiq u përgjigj se nuk është në dijeni me një kërkesë të tillë, ndërsa sipas Rregullores për financimin e OJQ-ve, për financimin deri në 500 euro nuk kërkohet thirrja publike, ndërsa çdo gjë tjetër me vlerë mbi 500 euro bëhet përmes thirrjes publike.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, pyeti se si financohet shoqata “Minatori” nga Kishnica.

Drejtori Sllavisha Niçiq u përgjigj se ata financohen përmes thirrjes publike për komunitete pakicë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro” miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, shpjegoi se është e nevojshme të rritet buxheti në një shumë prej 506,629.06 € për vitin 2024 nga të hyrat vetanake të komunës. Kjo shumë është planifikuar të rritet për: mallra dhe shërbime 100,000.00 €,

subvencione dhe transferta 218,193.55 €, investime kapitale 188,435.51 € për projektin e vjetër “Ndërtimi i ndërtesës së banimit social”.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro” miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes së mjeteve të pashpenzuara financiare nga viti 2024 në vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, shpjegoi se ka paraqitur kërkesë për transferimin e mjeteve financiare në një shumë prej 566,326.81 € nga viti 2024 në vitin 2025 nga të hyrat vetanake komunale. Shuma e transferuar në mallra dhe shërbime është 32,146.68 €, në shërbime komunale 34,861.75 €, në subvencione dhe transferta 25,720.85 € dhe në investime kapitale 473,597.53 €.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro” miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Rishqyrtimi dhe miratimi i Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit 2024-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integriteteve, Nebojsa Millovanoviq.

Kryesuesi shpjegoi se bëhet fjalë për një gabim teknik në emërtimin e pikës, sepse plani për periudhën 2025-2029 është miratuar në mbledhjen e mëparshme.

Zyrtari për zhvillim ekonomik dhe efikasitet të energjisë, Dejan Mitiq, shpjegoi se ministria kompetente vlerësoi se brenda Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit 2025-2029 duhet të ndryshohen udhëzimet administrative që janë shfuqizuar që atëherë, me një Udhëzim të ri administrativ.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro” miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Vlladica Trajkoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Vlladica Trajkoviq, tha se gjatë periudhës së dimrit, shërbimet punuan për mirëmbajtjen e rrugëve, ndriçimin, pastrimin e deponive të mbeturinave, sistemet e kanalizimeve dhe shtretërit e lumenjve. U mbajt një takim me përfaqësuesit e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” lidhur me bashkëfinancimin e projektit të furnizimit me ujë të vendbanimeve Batushë od Lepinë,

ku ka përfunduar faza e parë, ku komuna financon me 25,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër financohet nga Kompania e ujësjellësit.

Kryesuesi pyeti nëse kishte ndonjë gjë të re lidhur me ndriçimin publik.

Drejtori Vlladica Trajković u përgjigj se dje është nënshkruar kontrata, ndërsa sot në mëngjes është kontaktuar punëkryesi në mënyrë që të fillohet sot pasdite me heqjen e prishjeve. Me projekt është paraparë zëvendësimi i dritave të vjetra me Led drita të reja.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, tha se shpreson që drejtori dhe punonjësit e tij do ta monitorojnë punën e kompanisë që po e zëvendëson ndriçimin publik, në mënyrë që puna të mos bëhet paushall. Ai i kërkoi drejtorit ta përshpejtonte punën për pastrimin e shtretërve të lumenjve, si dhe të vendoset sinjalistika rrugore dhe të shënohen vendkalimet për këmbësorë sipas nevojës.

Drejtori Vlladica Trajković u përgjigj se zëvendësimin e ndriçimit publik do ta kryejë kompania nga Hajvalia me të cilën kemi pasur përvojë të mirë. Kemi në plan t'i pastrojmë shtretërit e lumenjve, thjesht po presim që të ketë sa më pak reshje në mënyrë që ta kryejmë punën në terren sa më mirë të jetë e mundur. Sa i përket sinjalistikës së trafikut, do të shohim me Drejtorinë e Urbanizmit, kërkesat e mëparshme që kemi marrë, për t'i zgjidhur këto probleme në periudhën e ardhshme.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, tha se në raport ceket se drejtoria ka punuar në largimin e prishjeve në kabllon e energjisë që i furnizon kamerat e sigurisë në vendbanimin Kishnicë deri në paralelën e ndarë të Shkollës fillore "Kralj Milutin". Ajo pyeti se çfarë po bëhet konkretisht atje.

Drejtori Vlladica Trajković u përgjigj se parcela që ishte blerë ishte pranë një nënstacioni elektrik dhe, kur e rrethoi, pronari e dëmtoi një shtyllë druri dhe kabllon e energjisë për kamerën, kështu që punëtorët e mi e rilidhën dhe ishte gati. Policia i dërgoi gjithashtu një kërkesë Drejtorisë së IT-së për ta rregulluar defektin në kabllon e energjisë për kamerën pranë shkollës në Sushicë, kështu që ne e rregulluam edhe atë defekt.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, paraqiti problemin e familjes Iviq nga Kishnica, për të cilën Ministria për Komunitete dhe Kthim filloi ndërtimin e një shtëpie vitin e kaluar. Ajo e pyeti drejtorin se si mund t'i sugjeronte komuna ministrisë që punimet të përshpejtohen.

Drejtori Vlladica Trajković u përgjigj se Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim bashkëpunon me ministrinë e lartpërmendur, ndërsa në bazë të kërkesave të paraqitura komisioni i formuar së fundmi del në terren, kështu që nuk kam asnjë informacion për familjen Iviq.

Asamblisti Nebojsa Marković, para partisë “SRPSKA”, e paraqiti problemin e rrjetin e ujësjellësit në rrugën “Dushan Silni” në Çagllavicë me një gjatësi prej 300 metra, ku kërkohen një zëvendësim i plotë.

Drejtori Vlladica Trajković u përgjigj se, duke u bazuar në takimet me Këshillin lokal të Çagllavicës, ai ndërhyri te kompania rajonale dhe ata zëvendësuan tubin nga rruga lokale Çagllavicë - Llaplasellë (deri në shkollë), megjithëse unë këmbëngula që puna të kryhej deri në stadium, por ata nxorën justifikimin se nuk kishin buxhet të mjaftueshëm. Kështu që do të kërkoj

një takim përsëri me ta, në mënyrë që ta zgjidhin këtë dhe disa probleme të tjera të ngjashme sa më shpejt të jetë e mundur.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, sugjeroi që nga drejtimi i Graçanicës - Llapllasellës të vendoset një shenjë trafiku për një kapacitet maksimal ngarkese prej 10 tonësh, ndërsa nga drejtimi i Llapllasellës kjo shenjë tashmë ekziston. Ai sugjeroi bashkëpunim më të madh me Stacionin e policisë së Graçanicës për ta parandaluar kalimin e kamionëve në rrugët lokale.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin nëse e kanë në plan ta pastrojnë kanalin përgjatë rrugës “Carica Milica”.

Drejtori Vlladica Trajkoviq u përgjigj se ata kanë një plan, por po presin që Ekologjia ta riparojë ekskavatorin, ndërsa sistemi i kanalizimit në atë zonë është gjithashtu i keq dhe nuk pastrohet rregullisht. Sipas disa informacioneve, një numër familjesh nga Badovci kanë derdhur ujëra të zeza nga bodrumet e tyre në një kanal kullues atmosferik.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin nëse ekziston mundësia për vendosjen e pasqyrës në dalje të rrugës “Carica Milica” në drejtim të rrugës kryesore.

Drejtori Vlladica Trajkoviq u përgjigj se ata duhet të paraqesin një kërkesë për këtë problem.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro” miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç.

Në mbledhje mungon asamblistja Sonja Odallovic, gjithsej janë të pranishëm 14 asamblistë dhe ka kuorum.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç, tha se Shërbimi i Sportelit mori mbi 900 kërkesa që u përpunuan vitin e kaluar, Shërbimi i Lejeve të Ndërtimit gjeneroi të ardhura në një shumë prej 574,929.11 €, si më poshtë: ndërrimi i destinimit të tokës 147,894.50 €, legalizimi 33,763.64 € dhe lejet ndërtimore 393,270.98 €. Nga dokumentacioni i shqyrtuar për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje në territorin e Komunës së Graçanicës, janë përpunuar gjithsej 117 lëndë. Shërbimi i Lejeve Mjedisore lëshoi 48 leje mjedisore dhe gjeneroi të ardhura prej 74,352.40 €. Zyrtarët kanë dalë rregullisht në terren për t'i vizituar përdoruesit e ndërtesave sociale në territorin e komunës dhe, duke vepruar kështu, kanë përpiluar raporte për gjendjen aktuale të rasteve. Më 16 prill, çelësat u

dorëzuan përfituesve për 34 njësi banimi në Suhadoll, në bashkëpunim me Këshillin Danez. Gjatë tetorit, u ndanë 45 banesa për ndërtesa sociale në Graçanicë dhe Llapllasellë. Drejtoresha Gjekiq tha se raporti përfshin edhe projektet e kryera nga Drejtorinë e Urbanizmit, si dhe menaxherët e projekteve, si dhe kodet e paguara nga Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", tha se i kishte shkruar KFOR-it vitin e kaluar, duke kërkuar që rruga (nga afër stadiumit në Kishnicë deri te varrezat ortodokse), që e kishin mbuluar, të rikthehej në gjendjen e saj ekzistuese, por deri më sot ata nuk kanë dhënë përgjigje. Kur e mbushën atë rrugë, ata ndërtuan një rrugë anësore, e cila është më e gjatë dhe kalon gjithashtu pranë një pjese të deponisë. Asamblistja Jovanović tha se do ta rinovonte kërkesën drejtuar KFOR-it. Ajo shtoi se e ka informuar OSBE-në për këtë, duke i kërkuar që të përfshiheshin dhe ta monitoronin atë.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtoreshën nëse kishte plane për ta shtruar rrugën "Carica Milica", sepse Këshilli lokal kishte paraqitur një kërkesë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se në këtë rrugë së pari duhet të rregullohet problemi me kanalizim dhe kanalin e shiut dhe pastaj asfaltimi i rrugës.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", e falënderoi Drejtorinë e Urbanizmit për zgjidhjen e një problemi që ekzistonte prej 10 vitesh lidhur me shpronësimin e tokës për zgjerimin e varrezave në Llapllasellë. Ai sugjeroi që fidanët të mbillen rreth ndërtesave të reja në Llapllasellë dhe që të bëhet diçka për problemin me infrastrukturën rrugore në mënyrë që komuna të mos detyrohet të asfaltojë rrugët çdo vit.

Asamblisti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtoreshën nëse planifikojnë ta bëjnë disa shtigje afër gardhit në parcelën e cila është shpronësuar për zgjerimin e varrezave në Llapllasellë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se nuk e kemi këtë në kod për momentin, sepse e gjithë shuma do të shkojë për shpronësim.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur është planifikuar të shtrohet rruga kryesore nga Hajvalia në Graçanicë, si dhe rindërtimi i trotuarit, ku kohët e fundit ndodhi një aksident trafiku.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se bëhet fjalë për rrugë rajonale, e cila është nën juridiksionin e

Ministrisë së Infrastrukturës dhe nëse ata nuk do të bëjnë asgjë lidhur me këtë, komuna do t'i riparojë përsëri gropat, njësoj siç kemi bërë vitin e kaluar në atë pjesë.

Asamblisti Nebojsa Marković, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtoreshën nëse Këshilli lokal i Çagllavicës duhet ta rinovojë kërkesën në lidhje me asfaltimin e rrugës që të çon në kishë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekij, u përgjigj se nevojiten mjete të mëdha për asfaltimin e asaj rruge, sepse për shkak të përroit nevojiten edhe disa ura.

Kryesuesi i kritikoi menaxherët e projektit, Goran Milliq dhe Ljazar Petroviq, për projektin: "Renovimi i rrugës "Car Lazar" në Gračanicë – Faza II". Nga Center Cafe deri në majë ka një kundërpjetë ku shtëpitë dhe rrugët janë më të ulëta se niveli i rrugës, dhe bordurat janë vendosur në mënyrë të tillë që të mos jeni në gjendje të hyni në oborr pa dëmtuar automjetin tuaj. Ia sugjerova këtë menaxherit të projektit dhe ai tha se do të rregullohej, por pas nëntë muajsh nuk ka ndodhur asgjë. Gjithashtu, kubet që u vendosën në fazën e dytë nuk u bënë si në fazën e parë, por u hodh vetëm rëra dhe gërmimet kanë filluar tashmë në disa vende. Kryesuesi e informoi drejtoreshën se do të merrte një kërkesë nga vendasit për të zgjidhur problemin dhe kërkoi që të mos e angazhonin më një kompani të tillë, sepse nuk donin të pranonin asnjë sugjerim.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekij, u përgjigj se menaxherët e projektit nuk mund të qëndrojnë pranë kontraktorëve për 16 orë, dhe atë që mundëm ta rregullonim, e rregulluam aty ku ishte problemi më i madh, dhe bordurat u ngritën pikërisht sepse disa vendas po protestonin kundër parkimit të makinave para shtëpive dhe dyqaneve të tyre.

Kryesuesi shtoi se menaxherët e projektit ishin të pranishëm kur është punuar faza e dytë dhe kur ai vetë ka sugjeruar disa gjëra. Ata është dashur ta ndalonin kontraktorin. Ai sugjeroi që, përveç gropave, të riparohen edhe kalimet hekurudhore, si dhe të shënohen kalimet për këmbësorë.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", e rikujtoi drejtoreshën se ajo ka sugjeruar, kur është punuar faza e parë, që nga rrethrotullimi deri në qendër të instalohen barrierat e parkimit përpara dyqaneve dhe vetëm dyqanet në rrethrotullim ishin të privileguara, dhe se pronarët e dyqaneve kishin paraqitur një peticion në lidhje me këtë problem. Ajo përmendi shembullin e një gruaje nga një grup turistikësh që po vizitonin manastirin, e cila ra mbi këtë barrierë dhe pësoi një tronditje.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekij, u përgjigj se qytetarët kishin nënshkruar një kërkesë për t'i hequr barrierat e

betonit mbi të cilat po pengoheshin disa këmbësorë sepse nuk i shihnin ato barriera. Asnjë shenjë kufitare nuk është instaluar kurrë në rrethrotullim sepse autobusët dhe automjetet e tjera ndalojnë atje.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 13 asamblistëve “Pro”, dhe 1 votë “Kundër” të Vlladica Qurçiqit miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Nërmarrjes publike “Ekologjia”, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç, shpjegoi se më 4 prill, ata pranuar një kërkesë nga Ndërmarrja publike-komunale "Ekologjia" se u nevojitej një parcelë me sipërfaqe 40 ari për ndërtimin e një ndërtese administrative, megjithatë, për shkak të vështirësisë së qasjes në terren në atë zonë, u propozua që t'u ndahej një parcelë me sipërfaqe 30 ari.

Kryesuesi pyeti nëse ajo parcelë përfshin edhe parcelën e konfiskuar aktualisht nga Qeveria e Kosovës.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç, u përgjigj se kjo parcelë nuk e përfshin parcelën që u konfiskua dhe ajo gjendet pranë parcelës që Kuvendi Komunal ia ndau Ujësjelesit.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 13 asamblistëve “Pro”, dhe 1 votë “Apstenim” të Vlladica Qurçiqit miratoi pikën e tetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit nr.29-2025-KG për shfuqizimin e Vendimit nr.1065/25 të datës 25.03.2025 (nr.17/2025/KG) për ndryshimin e emrit të rrugës nga “Pensilvania” në “Ohio”, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiç, shpjegoi se ata pranuar një kërkesë nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit. Pas një takimi me Agjencinë Kadastrale në Prishtinë, arritëm në përfundimin se sipas Rregullores së re, emrat e rrugëve nuk mund të ndryshohen deri në vitin 2029, prandaj vendimi duhet të shfuqizohet dhe vetëm rrugët që nuk kanë emra mund të emërtohen nga lista rezervë, e cila u miratua në vitin 2012.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e nëntë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Kadastrës për aktivitetet dhe të hyrat për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës, Dushan Fillipoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, Dushan Fillipoviq, e paraqiti raportin vjetor, duke thënë se në vitin 2024 ata pranuan gjithsej 8865 kërkesa dhe u gjeneruan të ardhura prej 155,072 €, për tarifat për transferimin e pronësisë, listat poseduese dhe kopjet e planeve, si dhe ndarjen dhe bashkimin e parcelave.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse ngjarjet e fundit që ndodhën në Drejtorinë e Kadastrës ndikuan në punën e vetë drejtorisë.

Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, Dushan Fillipoviq, u përgjigj se kishte pak ndikim, por ata kanë problem me numrin e punonjësve, duke pasur parasysh numrin e madh të lëndëve, kështu që i kam kontaktuar të gjitha drejtoritë në komunë për të na dërguar një numër të caktuar juristësh dhe punonjësish.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dhjetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përjashtimin e Shoqatës së gjuetarëve “Graçanica” nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për periudhën prej 12 muajsh, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se Shoqata e gjuetarëve ka kërkuar përjashtim nga pagesa e qirasë për vitin 2025, e cila arrin në 985.60 €, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pasi ato financohen ekskluzivisht nga tarifat e anëtarësimit të gjuetarëve.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, tha se vitin e kaluar ata vendosën gjithashtu ta përjashtonin Shoqatën e gjuetarëve nga pagesa e qirasë dhe se tani duhet ta mbështesin unanimisht këtë propozim.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se do ta mbështeste këtë vendim të propozuar, por se ishte në dijeni të një kërkesë tjetër nga Shoqata e gjuetarëve, në të cilën ata kërkuan 1 trimer dhe 1 makinë kositëse për mirëmbajtjen e oborrit, dhe besoj se ata duhet ta mbështesin edhe atë kërkesë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, gjithashtu e mbështeti këtë propozim për ta ndihmuar Shoqatën e gjuetarëve dhe sugjeroi t'i vizitonte ata për të mësuar se si funksionojnë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se do ta shpjegon informacionin në lidhje me subvencionet, dhe sa i përket vetë raportit, ai është në formë të shkruar, kështu që mund të na kontaktoni për çdo pyetje. Në periudhën mars-prill 2024, për konkursin e subvencioneve aplikuan gjithsej 789 aplikantë për mbi 5,000 ha tokë të punueshme. E reja në dy vitet e fundit është se aplikimi kryhet në dy periudha: në pjesën e parë, aplikimi bëhet për sipërfaqen e mbjellë, ndërsa në pjesën e dytë (nga 1 gushti deri në 1 shtator), aplikimi bëhet për plehun e përdorur dhe grurin e shitur. Komuna e Graçanicës ka publikuar thirrje publike për mbështetjen financiare publike për projekte-programe të OJQ-ve në fushën e bujqësisë në një shumë totale deri në 20,000 euro, ndërsa mjetet në vlerë prej 19,990 eurosh i përfitoi OJQ-ja - Qendra për Afirmimin Rinor, Graçanicë. OJQ-ja e lartpërmendur është e detyruar që, brenda tre muajve, pra deri më 31 dhjetor 2024, t'i kryejë të gjitha aktivitetet e dhëna në projekt (ndihmë për fermerët, kujdes për qentë endacakë, vaksinim të qenve, etj.). U zhvillua një bashkëpunim për të gjetur një veteriner i cili do të kryente aktivitetet e përcaktuara në projekt në lidhje me vaksinimin e qenve. U mbajt një ligjërata në fushën e bujqësisë me temën "Bujqësia sot dhe nesër me praktikantë", si dhe përfshirja e inovacioneve në bujqësi si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave në këtë sektor. Së bashku me organizatën e lartpërmendur, vendosëm bashkëpunim me strehimoren e qenve në Llapllasellë "E drejta në jetë" dhe siguroam ushqim për strehimoren në përputhje me projektin. Si pjesë e këtij projekti, u krye puna për vaksinimin e qenve, ku 30 qen u vaksinuan bazuar në aplikim, në bashkëpunim me një veteriner të licencuar. Ndhimë iu ofrua edhe fermerëve në formën e stimujve për donacionet e naftës, ku ndihmuam 117 fermerë. Kur bëhet fjalë për peshkim, 20 karpa u peshkuan në liqenin e Graçanicës.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kush e kontrollon punën e strehimores së qenve.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se ata e kontrollojnë punën e tyre dhe se kanë problem me ta sepse nuk duan të bashkëpunojnë.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", u përgjigj se në mbledhjet e Komitetit të Komunitete flitet për problemin me qentë endacakë dhe se duhet të gjendet një zgjidhje, sepse ajo OJQ merr mjete nga komuna për një strehimore për qen, dhe pastaj kemi qen në rrugë. Ajo pyeti se cilët qen ishin vaksinuar, sepse 30 qen të vaksinuar janë një numër shumë i vogël.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se qentë ishin vaksinuar në bazë të aplikacionit, që do të thotë se ishin vaksinuar ata shtëpiak. Drejtori Gjuroviq shtoi se sipas informacionit nga OJQ-ja "E Drejta në jetë", qentë endacakë sillen nga komunat përreth natën dhe lirohen në territorin e Komunës së Graçanicës.

Asambleti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtori a mund të bëjnë diçka lidhur me pyllëzimin e pyjeve.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se pyjet që nga ky vit janë transferuar tek niveli qendror dhe janë nën juridiksionin e tyre..

Asambleti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", propozoi që organizatat joqeveritare që merren me çështjet mjedisore të dhurojnë mjete për fidanë, në mënyrë që territori i Komunës së Graçanicës të gjelbërohet sa më shumë që të jetë e mundur.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", paraqiti një sugjerim lidhur me pyllëzimin duke thënë se në Graçanicë është një familje e cila merret me fidanë dhe se ndoshta mund të bëhet një marrëveshje me ta për të subvencionuar dhe për t'i lejuar ata të rrisin fidanë të rinj: lis, pishë dhe bli, në mënyrë që të mos blihen fidanë të mëdhenj që janë të shtrenjtë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblestëve "Pro", miratoi pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se në pikën e mëparshme e kishte shpjeguar ndarjen e subvencioneve.



Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës:

14. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:48.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević